



**BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO**  
**AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS**  
**BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA**

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 29 Prill 2005, mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 të dates 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të implementimit të Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20, për përcaktimin e Përfituesit.

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës , në mbledhjen e mbajtur me 16 Mars 2006 miraton si vijon:

## **Rregulla 25 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Përcaktimin e Përfituesve të Pensioneve të datës 17 Prill 2003**

### **Neni 1**

#### **Sfera dhe qëllimi I kësaj Rregulle**

##### **1.1 Sfera e Rregullës**

Kjo rregull I adresohet përcaktimit të Përfituesit për Trustin e Kursimeve të Pensioneve të Kosovës (“Trusti”)

##### **1.2 Qëllimi I Rregullës**

Kjo Rregull parashkruan kërkesat për përcaktimin dhe anulimin e Përfituesit sipas Nenit 12.6 dhe pasqyron Nenin 12.7.

### **Neni 2**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

##### **2.1 Definimet**

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar në Rregulloren e Pensioneve dhe/ose siq definoohen më tutje në këtë Rregull.

“Përfitues” nënkupton personin natyror të titulluar që të pranoj beneficinin e pensionit pas vdekjes së Pjesmarrësit. Pjesmarrësi mund të caktoj një ose më shumë përfitues.

“Përcaktimi I Përfituesit” nënkupton dokumentin e nënshkruar nga Pjesmarrsi të arhivuar në Trust, me të cilin emron Përfituesin.

“Përfituesi I mundshëm” nënkupton personin natyror I cili do të marr të drejtën e përfituesit në rast se nuk ka përfitues primar të titulluar për të pranuar beneficinin e pensionit të pjesmarrësit të vdekur.

“Përfituesi primar” nënkupton personin natyror të titulluar për të pranuar beneficinin e pensionit të pjesmarrësit të vdekur duke përjashtuar të gjithë përfituesit e tjerë të caktuar.

“Anulimi I përfituesit” nënkupton dokumentin e arhivuar në Trust nga Pjesmarrësi që anulon, ndryshon, ose në ndonjë mënyrë tjetër e ndryshon Përfituesin e emruar.

“Bashkëshorti” nënkupton personin me të cilin pjesmarrësi është I martuar me ligj ose personin me të cilin bashkëjeton pjesmarrësi dhe I cili është I njohur si bashkëshort sipas qertifikatës së bashkëjetesës ,valide sipas ligjeve të Kosoves

### **Neni 3**

#### **Përcaktimi I Përfituesit**

##### **3.1 Përfituesi primar**

a.Nëse pjesmarrësi në kohën kur e përcakton përfituesin është I martuar, ai duhet të emrojë si përfitues bashkshortin ose bashkshorten..

b.Partneri me të cilin pjesmarrësi ka qenë I martua ose me të cilin ka bashkëjetuar së paku një (1) vit para vdekjes së tij, është përfituesi primar, pavarësisht se a e ka bërë pjesmarrësi emrimin e përfituesit të tillë, dhe kjo ka përparsi ndaj të drejtave të të gjithë përfituesve të tjerë.

c.Partneri, me të cilin pjesmarrësi ka qenë I martuar ose me të cilin ka bashkëjetuar për më pak se një (1) vit para vdekjes së tij, dhe që është përcaktuar nga pjesmarrësi si përfitues I asaj apo atij ka përparsi ndaj të drejtave të të gjithë pjesmarrësve të tjerë

d.Partneri, me të cilin pjesmarrësi ka qenë I martuar ose me të cilin ka bashkëjetuar për më pak se një (1) vit para vdekjes së pjesmarrësit, dhe nuk është përcaktuar nga pjesmarrësi si përfituesi I asaj apo atij ndan të drejtën e barabartë me përfituesin(it) tjetër primar, ose me përfituesin(it) e mundshëm, nëse ka.

e.Nëse pjesmarrësi në kohën kur përcakton përfituesin është I pamartuar mirpo ka një fëmijë ose më shumë fëmijë duhet të përcaktoj të gjithë fëmijët e saj apo atij si përfitues(it).

f.Fëmiju I Pjesmarrësit , pavarësisht se a është përcaktuar ose jo do të konsiderohet si Përfitues(it) primar, në rast se nuk ka bashkshort I cili mundë të ushtrojë të drejtën e përfituesit primar në kohën e pagesës së beneficinit të pensionit.

g.Nëse pjesmarrsi në kohën kur e përcakton përfituesin është I pa martuar dhe nuk ka fëmij, mundë të përcaktoj qdo person natyror si përfitues (it) të atij apo asaj. Në rast se nuk ka përfitues primar në kohën e pagesave të beneficioneve të pensioneve, të gjithë personat e emruar duhet të kenë hise të barabartë.

h.Ndarja e beneficioneve të pensioneve për të gjithë përfituesit primar, nëse janë më shumë se një duhet të bëhet në mënyrë të barabart.

##### **3.2 Përfituesi I mundshëm**

a.Pjesmarrësi mundë të përcaktoj qdo person ose persona natyror si përfitues(it) të mundshëm.

b.Ndarja për përfituesit e mundshëm duhet të jetë e barabartë për të gjithë.

c.Ekzistenca e përfituesit (ve) primar përjashton të drejtat e përfituesit(ve) të mundshëm.

d.Përfituesit e mundshëm kanë të drejtë të pranojnë beneficionet e pensionit të pjesmarrsit të vdekur vetëm në mungesë të përfituesit primar ose kur nuk ka caktim efektiv të përfituesit primar.

### **3.3 Mungesa ose jovaliditeti I përcaktimit të përfituesit**

Përfituesi (it) i pjesmarrësit të vdekur I cili nuk ka partner dhe I cili nuk e ka përcaktuar përfituesin, janë të gjithë fëmijët e saj apo atij, ose nëse ajo apo ai vdes pa pasur fëmijë, atëhere trashëgimtari I tij më I afërt I saj apo atij vjen në shprehje sipas ligjit të aplikueshëm.

## **Neni 4**

### **Anulimi I përfituesve**

#### **4.1 Kufizimet në të drejtat e Pjesmarrësit për të Anuluar emrimin e përfituesit**

Pjesmarrësi ka të drejtë që të anuloj caktimin e përfituesit të asaj apo atij, varsisht prej kufizimeve në vijim:

a.Pjesmarrësi nuk mundë të anuloj emrimin e bashkshortit ose bashkshortes me të cilin ajo apo ai është I martuar legalisht, si përfitues I beneficionit të pensionit të asaj apo atij.

b.Dekreti ligjor i urdhërit për shkurorzim nuk mundë të vepron si anulim i emrimit të përfituesit. Pjesmarrësi I cili është palë për shkurorzim mundë të anuloj emrimin e ishpartnerit të asaj apo atij sipas procedurave të parashkruara në Nenin 5 të kësaj Rregulle. Nëse ky anulim nuk është bërë para vdekjes së pjesmarrësit, partneri I tillë nuk mundë të përjashtoj të drejtat e përfituesve të tjerë primar si bashkëshortja që pason apo fëmijët.

c.Pjesmarrsi mundë të anuloj në qdo kohë emrimin e përfituesit por jo të partnerit me të cilin është I martuar.

## **Neni 5**

### **Kërkesat për emrimin ose anulimin valid dhe efektiv të përfituesit**

#### **5.1 Kërkesat**

Caktimi dhe anulimi I përfituesit që të jetë valid dhe efektiv duhet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat në vijim:

a.Duhet të jetë bërë nga pjesmarrsi gjat kohës kur ai është gjallë dhe para fillimit të pensioneve.

b.Duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga pjesmarrësi dhe të jetë pranuar nga Trusti.

c.Nuk duhet të ndryshoj të drejtat e partnerit të pjesmarrsit në kohën e emrimit.

d.Duhet të jetë në përputhshmëri me kërkesat e aplikueshme të rregullave të emrimit të përfituesit të Trustit që janë në pajtim me këtë Rregull dhe Rregulloren e Pensionit.

## **Neni 6**

### **Përbushja e obligimeve**

- 6.1 Pagesa ose pagesat e beneficionit të pensioneve të bëra nga Trusti në pajtim me këtë Rregull I përbushin obligimet e Kujdestarve ndaj qdo personi që bënë kërkesë si përfitues I pjesmarrësit të vdekur.

## **Neni 7**

### **Pagesa fazore**

#### **7.1 Pagesat Fazore**

Pagesat fazore mundë të bëhen nëse vlera e llogarisë individuale e tejkalon vlerën e pragut apo kufirit të aprovuar nga BPK-ja, mirpo prap është e pamjaftueshme për të blerë një anuitet.

#### **7.2 Pagesat e pagesave fazore për përfituesit**

Nëse pagesa fazore e beneficioneve është bërë nëpërmes të ndonjë institucioni tjetër, dhe pjesmarësi vdes para pranimit të të gjitha pagesave, ai institucion duhet të përshtatet me kërkesat për përcaktimin e përfituesit të caktuar më parë në këtë Rregull dhe të ja paguaj përfituesit pagesat që kanë mbetur. Institucioni duhet të mbaj shënime të caktimit të përfituesit dhe të ofrojë mundësi për anulimin e caktimit të përfituesit nëse kjo kërkohet.

## **Neni 8**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregull si e ndryshuar do të hyj në fuqi me 01 Prill 2006.

Michel Svetchine  
Drejtori i Përgjithshëm